

Njesiti eshte e njeste me origjinalin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN

Adresa: Lagjia "Qender" Polican ; Tel:036824200 ; Email: polican@gov.al

Nr. 249/ Prot
52

Polican, me 08.10.2014

KONTRATË

"PER MBIKQYRJEN E PUNIMEVE"

E lidhur sot me date 08.10.2014 ne Polican, midis Bashkise Polican, me NIPT K49312401S perfaqesuar nga Z. Adriatik Zotkaj, titullari i institucionit, me poshte i quajtur "Autoriteti Kontraktor"

dhe

Mbikqyresit (Drejtorit te Punimeve), "A.Sh. Engineering" sh.p.k , me nr. licence MK.2463/1 date 03.06.2013, me NIPT L31617003F, perfaqesur nga perfaqesuesi ligjor Z. Arian Shtembari.

I. OBJEKTII KONTRATES

Objekti i kontrates eshte mbikqyrja e punimeve qe do te kryhen ne zbatim te projektit, per objektin e prokurimit: "Rikonstruksioni i Kopeshtit Nr.2 Polican"

II. VLERA E KONTRATES SE ZBATIMIT

Vlera e punimeve te zbatimit per objektin e prokurimit: "Rikonstruksioni i Kopeshtit Nr.2 Polican", ne perputhje te plote me vleren e ofertes fituese prej 3.448.440 (tre milion e katerqind e dyzete e tete mije e katerqind e dyzete) leke pa TVSH dhe vlere kontrate 4.138.128 (kater milion e njeqind e tridhete e tete mije e njeqind e njezete e tete) leke me TVSH, do te kryhet nga sipermarresi "BEQIRI" Sh.p.k.

III. AFATI I PUNIMEVE

Afati i perfundimit te punimeve te kontrates se zbatimit te punimeve do te jete 45 (dyzet e pese) dite nga data e fillimit te punimeve.

IV. PAGESA E MBIKQYRESIT

Pagesa e mbikqyresit do te behet ne baze te VKM nr. 444 date 05.09.1994, ne vleren 56.000 (pesedhete e gjashte mije) leke pa TVSH dhe 67.200 (gjashtedhete e shtate mije e dyqind) leke me TVSH.

V. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

- Mbikqyresi ka te drejte te mbaje dhe te pergjigjet per dokumentacionin e meposhtem:
 - a) Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesit dhe porositesit sipas juridiksionit.
 - b) Dokumentacionin topografik dhe gjeologjinxhinierik te themeleve, te bazamenteve dhe te punimeve te maskuara.
 - c) Dokumentacionin per te gjitha ndryshimet e mundeshme qe mund te jene bere ne projekt gjate ndertimit te objektit, pa prekur kushtet e vena ne vendimin e KRRT-se.
 - d) Planorganizimin e punimeve: kontrollon periodikisht dhe ne fazat me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per sakesimin e vertetesise se dokumentave qe pasqyrohen ne te.
- Mbikqyresi ka te drejte te njoftoje pushtetin vendor per fillimin e punimeve mbasi ka marre verifikimet ne baze te pikes 5 te UKM nr. 3 date 15.02.2001 dhe UKM nr. 2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve ne ndertim"
- Mbikqyresi, gjate zbatimit te objektit, i jep instruksione dhe urdhera me shkrim sipermarresit. Ai ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet per zbatim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, ne cdo rast me miratimin e investitorit, per aq kohe sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes, gjithashtu ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose disa personave nga personeli i sipermarresit.
 - Arsyet kryesore te propozimit per largimin nga puna mund te jene: moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftesia dhe arbitrariteti ne zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi te renda.
- Mbikqyresi ka te drejte te kontrolloje materialet qe vijne ne kantier te cilat duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te projektit. Materialet e ardhura si dhe pajisjet e siguruara nga sipermarresi, te cilat nuk paranohehen nga mbikqyresi, zevendesohen me te tjera me shpenzimet e sipermarresit.
- Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te siguroje nga sipermarresi per materialet e perdorura, certifikatat qe garantojne cilesine e tyre nga enti furnizues dhe per prodhimet e




[Handwritten signature]

[Circular stamp: INSTITUTI QENDRORE I PROJEKTIMIT DHE INZHENERIAVE]

[Circular stamp: KSHI E INZHENERIAVE]

kryera prej sipermarresit certifikata te leshuara nga laboratoret e autorizuar per kete qellim.

- Mbikqyesi ka per detyre mirembajtjen e dokumentacionit dhe korrespondences midis tij dhe investitorit, midis tij dhe sipermarresit.
- Mbikqyesi i punimeve ka per detyre qe cdo muaj ti relatoje investitorit grafikun e realizimit te punimeve si dhe per kontrollin e perdorimit te fondit.
- Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikqyresit te punimeve. Sipermarresi duhet te njoftoje mbikqyresin kur punimet jane gati per tu ekzaminuar prej tij.
- Mbikqyesi i punimeve miraton dhe kontrollon situacionet e paraqitura nga sipermarresi. Pagesa mund te kryhet vetem ne baze te ketij miratimi. Keto dokumenta dergohen ne sektorin financiar te punedhenesit, bashke me vertetimin e perkohshem te pageses, per te shpallur vleren e detyrueshme per pagim.
- Mbikqyesi i punimeve kontrollon dhe autorizon, me miratim nga investitori perdorimin e fondit rezerve te preventivuar dhe i raporton periodikisht, per gjendjen e tij. Ky i fundit nese ka verejtje e njofton sipermarresin dhe problemi zgjidhet prej tyre. Per cdo ndryshim te mundshem mbikqyesi i punimeve vihet ne dijeni per te ndjekur zbatimin e ndryshimeve ne fjale.
- Ne rastin e nderrimit te mbikqyresit te punimeve, mbahet procesverbli i dorezimit te dosjes se punimeve, ku shenohen dhe shkaqet e ketij nderrimi. Dokumentacioni i mbikqyresit te vjeter i dorezohet mbikqyresit te ri. Investitori mund te kerkoje largimin dhe zevendesimin e mbikqyresit kur vertetohen mangesi serioze ne veprimtarine e tij si:
 - a) Mangesi me plotesimin e detyrave te percaktuara ne piken 1 te UKM nr.3 date 15.02.2001 "Per Mbikqyrje e Kolaudim Punimesh" dhe UKM nr.2 date 13.05.2005 "Per Zbatimin e Punimeve ne Ndertim"
 - b) Nderprerje e paarsyeshme e punime dhe zgjatje e theksuar e tyre.
 - c) Mangesi kontrolli ne kostot e kontabilitetit, tolerim i materialeve mbi vleren mbi ato te preventivuara ose me cilesi jo te mire.
- Mbikqyesi i punimeve mbasi merr njoftim me shkrim, per perfundimine e punimeve nga sipermarresi, merr pjese ne kolaudimin e vepres dhe i pergjigjet kolaudatorit me te gjitha dokumentacionin e nevojshem per kolaudimin e vepres, si dhe firmos procesverbalin e ketij kolaudimi. Pas perfundimit te kolaudimit, mbikqyesi i punimeve, mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjeter, percakton vleren perfundimtare te objektit, e

cila i behet e ditur sipërmarresit si dhe i jepete per likujdim investitorit.

- Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, investitori dhe dikasteri nga varet ky investitor si dhe deget e policise se ndertimit, kane te drejte te urdherojne mbikqyresin e punimeve per nderprejten e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimine gjendjes.
- Kur shkeljet e dispozitave ligjore perbejne kundervajtje administrative, vendosen sanksione ne baze te neneve 15, 16 te kreut 3 te ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 "per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", ndryshuar me ligjin nr.9794 date 23.07.2007.

Kontrata perbehet nga 4 (kater) flete dhe hartohet ne tre kopje.

AUTORITETI KONTRAKTOR

**KRYETARI I BASHKISE
ADRIATIK ZOTKAJ**

Adriatik Zotkaj



MBIKQYRESI I PUNIMEVE

**A.SH ENGINEERING SH.P.K
ARIAN SHTËMBARI**

Arian Shtembari

